



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-12

**Prokurorja e Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim
Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit**

Vendosi: Gjykatësja e Procedurës Paraprake

Gjykatëse Marzhori Masëlo

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 7 shkurt 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Fadil Fazliut

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Nina Tavakoli
Sofi Menegon

Mbrojtjes së Bashkim Smakajt
Bas Martens

Administratores
Fidelma Donlon

Mbrojtjes së Isni Kilajt
Ian Edwards
Xho Holms

Mbrojtësit kujdestar të Fadil Fazliut
Mihil Pestman

Mbrojtjes së Hajredin Kuçit
Aleksandër Admiral

GJYKATËSJA E PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 41(6), (10) dhe (12) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 5 dhjetor 2024, Fadil Fazliu (“z. Fazliu” ose “i akuzuari”) u arrestua në Kosovë² në bazë të vendimit dhe fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake (“Vendimi për Arrestim”),³ me kërkesë të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”),⁴ dhe në vijim të konfirmimit të Aktakuzës kundër tij, Hashim Thaçit (“z. Thaçi”), Bashkim Smakajt, Isni Kilajt dhe Hajredin Kuçit (“Vendimi i Konfirmimit”).⁵ Më të njëjtën ditë Administratorja caktoi Mihil Pestman mbrojtës kujdestar për të akuzuarin.⁶

2. Më 8 dhjetor 2024, në paraqitjen e parë të z. Fazliu,⁷ Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Fazliu (“Vendimi i Parë për

¹ KSC-BC-2023-12, F00015, Kryetarja, [Decision Assigning a Pre-Trial Judge](#), (Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake) 6 qershor 2024, publik.

² KSC-BC-2023-12, F00045, Administratorja, *Njoftim për Arrestimin e Fadil Fazliut sipas Rregullës 55(4)*, 5 dhjetor 2024, publik.

³ KSC-BC-2023-12, F00037, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Çështje Përkatëse*, 29 nëntor 2024, konfidencial, me Shtojcat 1-8, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik i parashtrimit kryesor u lëshua më 19 dhjetor 2024, [F00037/RED](#).

⁴ KSC-BC-2023-12, F00003, Prokurorja e Specializuar, *Kërkesa për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Kërkesa në lidhje me To*, 31 janar 2024, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 27 nëntor 2024, F00003/CONF/RED. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 13 dhjetor 2024, F00033/RED; F00021, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime Plotësuese të Prokurorisë në lidhje me Kërkesat për Lëshimin e Fletarrestimeve (F00003 & F00018)*, 2 shtator 2024, publike.

⁵ KSC-BC-2023-12, F00036, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 29 nëntor 2024, konfidencial.

⁶ KSC-BC-2023-12, F00051, Administratorja, *Njoftim për Caktimin e Mbrojtësit Kujdestar për Fadil Fazliun*, 6 dhjetor 2024, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁷ KSC-BC-2023-12, Transkripti i seancës (“Transkripti i Seancës së Paraqitjes së Parë”), 8 dhjetor 2024, f. 45-69, publik.

Paraburgimin”)⁸ dhe caktoi afatet për dorëzimin e parashtrimeve nga palët lidhur me rishikimin e paraburgimit të z. Fazliu.⁹

3. Më 21 janar 2025, në përputhje me urdhrin e Gjykatës së Procedurës Paraprake, ZPS-ja paraqiti parashtrime në lidhje me rishikimin e paraburgimit (“Parashtrimet e ZPS-së”).¹⁰

4. Mbrojtja e z. Fazliu nuk dorëzoi parashtrime në lidhje me paraburgimin e z. Fazliu.¹¹

II. PARASHTRIMET

5. ZPS-ja parashtron se vazhdimi i paraburgimit të z. Fazliu vijon të jetë i përligjur dhe i domosdoshëm,¹² sepse nuk ka pasur ndonjë ndryshim të rëndësishëm të rrethanave që të përligjë shmangien nga vendimet e marra nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake në Vendimin për Arrestim dhe Vendimin e Parë për Paraburgimin.¹³ Sipas ZPS-së: (i) ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Fazliu ka kryer vepër penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara (“DHS”);¹⁴ dhe (ii) vazhdojnë të vlejné arsyet për paraburgimin e tij sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit.¹⁵ Në veçanti, ZPS-ja parashtron se dijenia e z. Fazliu për akuzat dhe nxjerrja në vijimësi e materialeve që i mundësojnë z. Fazliu qasje të mëtejshme në informacion të ndjeshëm ku tregohet kuadri i plotë i akuzave, e përforcojnë domosdoshmërinë e mbajtjes së tij në paraburgim.¹⁶ ZPS-ja gjithashtu parashtron se: (i) asnjë modalitet

⁸ *Shih* Transkriptin e Seancës së Paraqitjes së Parë, f. 68, rreshtat 8-9.

⁹ *Shih* Transkriptin e Seancës së Paraqitjes së Parë, f. 68, rreshti 24 deri në f. 69, rreshti 13.

¹⁰ KSC-BC-2023-12, F00129, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit të Fadil Fazliut* (“Parashtrimet e ZPS-së”), 21 janar 2025, publik.

¹¹ Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton konstatimet e saj në paragrafët 27-31 dhe 32(b) në vendimin KSC-BC-2023-12, F00137, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën Referuese të Administratores sipas Pjesës 12(5) të Direktivës për Mbrojtësit*, 27 janar 2025, publik.

¹² Parashtrimet e ZPS-së, para. 11.

¹³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 13.

¹⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 11, 12-13.

¹⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 11, 14-16, 17-19, 20-21.

¹⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 15, 18-19, 21.

i lirimit të përkohshëm nuk mund të zvogëlojë mjaftueshëm rreziqet ekzistuese;¹⁷ dhe (ii) duke pasur parasysh fazën e procesit dhe përparimin e bërë deri tani, mbajtja në paraburgim e z. Fazliu vazhdon të jetë e arsyeshme dhe proporcionale.¹⁸ Mbi këtë bazë, ZPS-ja kërkon që z. Fazliu të mbetet në paraburgim.¹⁹

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në bazë të nenit 41(6) të Ligjit, DHS-ja urdhëron paraburgimin e një personi vetëm nëse (a) ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer një vepër penale që përfshihet në juridiksionin e DHS-së; dhe (b) ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se personi: (i) mund të arratiset; (ii) do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë apo falsifikojë provat e një veprë penale, ose do të pengojë ecurinë e procesit penal përmes ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryesit; ose (iii) do të përsërisë veprën penale, do të përfundojë një vepër penale të tentuar, ose do të kryejë një vepër penale që ka kërcënuar se do ta kryejë.

7. Në bazë të nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, deri në momentin që aktgjykimi merr formë të prerë ose deri në lirimin nga paraburgimi, me kalimin e dy (2) muajve nga vendimi i fundit për mbajtje në paraburgim, paneli i ngarkuar me çështjen gjyqësore shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim dhe nxjerr vendim për vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit.

8. Në bazë të nenit 41(12) të Ligjit, krahas masës së paraburgimit, për të siguruar praninë e të akuzuarit, përfshirë nëpërmjet videokonferencës, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale ose për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të procesit penal, DHS-ja mund të urdhërojë edhe masat në vijim: fletëthirrja, arrestimi, dorëzania, arresti shtëpiak, premtimi për të mos u larguar nga vendbanimi, ndalimi

¹⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 22-27.

¹⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 28.

¹⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 29.

për t'iu afruar vendeve ose personave të caktuar, paraqitja në stacionin e policisë apo në ndonjë vend tjetër dhe masa alternative shmangëse.

9. Në bazë të rregullës 56(2) të Rregullores, gjykatësi i procedurës paraprake siguron që personi të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes, dhe, në rast të ndonjë vonese të paarsyeshme të shkaktuar nga prokurori i specializuar, paneli, pas dëgjimit të palëve, mund ta lirojë personin me kushte që i gjykon të arsyeshme.

IV. DISKUTIM

A. STANDARDI I ZBATUESHËM

10. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se, në bazë të nenit 41(10) të Ligjit, ajo ka detyrimin të shqyrtojë çdo dy muaj nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim,²⁰ ndër të cilat arsyet e përcaktuara në nenin 41(6) të Ligjit, konkretisht nëse: (i) ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer vepër ose vepra penale sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit; dhe (ii) ka arsye të artikulueshme për të besuar se ekziston ndonjë prej rreziqeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.²¹

²⁰ Shih, për shembull, KSC-BC-2020-07, IA002/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Decision on Nasim Haradinaj's Appeal Against Decision Reviewing Detention](#) (Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit) ("Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Haradinajt"), 9 shkurt 2021, publik, para. 55; KSC-BC-2020-06, IA006/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Jakup Krasniqi's Appeal Against Decision on Review of Detention](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Jakup Krasniqit ndaj Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit), ("Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit"), 1 tetor 2021, publik, para. 15; KSC-BC-2020-04, F00224/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Review of Detention of Pjetër Shala](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës), ("Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin e Shalës"), 22 qershor 2022, publik, para. 19.

²¹ Shih, për shembull, [Sixth Shala Detention Decision](#), (Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin e Shalës) para. 19; [First Haradinaj Detention Appeal Decision](#), (Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Haradinajt), para. 55. Shih gjithashtu KSC-BC-2020-04, F00075/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Review of Detention of Pjetër Shala](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës), ("Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin e Shalës"), 10 shtator 2021, publik, para. 19; KSC-BC-2020-07, F00143, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Decision on Review of Detention of Hysni Gucati](#), (Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hysni Gucati), 24 shkurt 2021, publik, para. 17.

Detyrimi për të përcaktuar nëse ekzistojnë ende rrethanat mbi të cilat u bazua paraburgimi i ngarkon Gjykatës së Procedurës Paraprake detyrën që të vlerësojë, *proprio motu*, nëse në kohën e rishikimit dhe duke pasur parasysh rrethanat konkrete të çështjes kur bëhet rishikimi, është ende e bindur se paraburgimi i personit vazhdon të jetë i përligjur.²² Ky rishikim automatik çdo dy (2) muaj nuk kufizohet rreptësisht në faktin nëse ka ndodhur apo jo ndryshim në rrethanat e çështjes, ndonëse një ndryshim i tillë mund të jetë përcaktues dhe duhet të merret parasysh në qoftë se ngrihet nga njëra prej palëve ose *proprio motu*.²³ Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mund t'u referohet konstatimeve në vendimet e mëparshme, në qoftë se është e bindur se provat ose informacioni ku bazohet ato vendime ende mbështesin konstatimet e bëra në kohën e rishikimit.²⁴ Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk është e detyruar të bëjë konstatime në lidhje me faktorë për të cilët tashmë është vendosur në Vendimin e Parë për Paraburgimin, as të shqyrtojë parashtrime që thjesht përsërisin argumente të trajtuara tashmë në vendime të mëparshme.²⁵

11. Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu nënvizon se në çdo analizë të paraburgimit të z. Fazliu duhet të merret parasysh në masën e duhur prezumimi i

²² [Second Krasniqi Detention Appeal Decision](#), (Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit), para. 15; [Sixth Shala Detention Decision](#), (Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin e Shalës), para. 19.

²³ Shih [Second Krasniqi Detention Appeal Decision](#), (Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit), para. 16; [Sixth Shala Detention Decision](#), (Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin e Shalës), para. 19.

²⁴ KSC-BC-2020-04, IA003/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Pjetër Shala's Appeal Against Decision on Review of Detention](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit), ("Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Shalës"), 11 shkurt 2022, publik, para. 18. Shih gjithashtu [Sixth Shala Detention Decision](#), (Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin e Shalës) para. 19.

²⁵ [First Haradinaj Detention Appeal Decision](#), (Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Haradinajt), para. 55; [Second Krasniqi Detention Appeal Decision](#), (Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit), para. 17; [Second Shala Detention Appeal Decision](#), (Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Shalës), para. 18; [Sixth Shala Detention Decision](#), (Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin e Shalës), para. 19.

pafajësisë së tij.²⁶ Kjo, si rrjedhojë, do të thotë se për vazhdimin e paraburgimit të tij nuk mund vendoset me lehtësi dhe ZPS-ja ka detyrimin të vërtetojë se paraburgimi i personit është i domosdoshëm.²⁷ Kjo gjithashtu do të thotë se ZPS-ja duhet të japë argumente dhe prova konkrete për të vërtetuar se vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm në kohën kur kryhet rishikimi.²⁸

B. DYSHIMI I BAZUAR

12. Sa i përket standardit për vazhdimin e rishikimit, neni 41(6)(a) i Ligjit kërkon ekzistencën e dyshimit të bazuar²⁹ se personi i paraburgosur ka kryer vepër penale që përfshihet në juridiksionin e DHS-së. Ky është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimin të paraburgimit të personit të paraburgosur.³⁰

13. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se, në Vendimin e Konfirmimit, u përcaktua se, në bazë të nenit 39(2) të Ligjit, ekziston dyshimi i bazuar mirë se z.

²⁶ Shih KSC-BC-2020-06, F00177/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Hashim Thaçi's Application for Interim Release](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Hashim Thaçit për Lirim të Përkohshëm), ("Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Thaçit"), 22 janar 2021, para. 18; KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, [Judgment on the Referral of the Rules of Procedure and Evidence Adopted by Plenary on 17 March 2017 to the Specialist Chamber of the Constitutional Court Pursuant to Article 19\(5\) of Law No. 05/L-053 on Specialist Chambers and Specialist Prosecutor's Office](#) (Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar), ("Aktvendimi i DHSGJK-së i datës 26 prill 2017"), 26 prill 2017, publik, para. 113. Ngjashëm, ECtHR, [McKay v. the United Kingdom](#), no. 543/03, Judgment, 3 October 2006, para. 43.

²⁷ Shih, për shembull, KSC-BC-2020-04, F00045/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Pjetër Shalës's Request for Provisional Release](#) (Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Pjetër Shalës për Lirim të Përkohshëm), ("Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Shalës"), 23 qershor 2021, publik, para. 13; [First Thaçi Detention Decision](#) (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Thaçit), para. 19, me referenca të mëtejshme. Shih gjithashtu ECtHR, [Merabishvili v. Georgia](#), no. 72508/13, Judgment ("Merabishvili v. Georgia"), 28 November 2017, para. 234.

²⁸ [Sixth Shala Detention Decision](#), (Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin e Shalës), para. 19.

²⁹ Shih nenin 19(1)(1.9) të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2022, Kodi nr. 08/L-032 ("KPPK"). Shih ngjashëm, nenin 5(1)(c) të Konventës (Evropiane) për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, sikurse interpretohet nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në, ndër të tjera, ECtHR, [Fox, Campbell and Hartley v. United Kingdom](#), nos 12244/86; 12245/86; 12383/86, Judgment, 30 August 1990, para. 32; [Erdagöz v. Turkey](#), no. 21890/93, Judgment, 22 October 1997, para. 51; [Ilgar Mammadov v. Azerbaijan](#), no. 15172/13, Judgment, 22 May 2014, para. 88; [Selahattin Demirtaş \(No. 2\) v. Turkey](#), no. 14305/17, Judgment, 22 December 2020, para. 314.

³⁰ [First Shala Detention Decision](#) (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Shalës), para. 14. Shih gjithashtu ECtHR, [Merabishvili v. Georgia](#), para. 222.

Fazliu është penalisht përgjegjës për vepra penale që përfshihen në juridiksionin e DHS-së, konkretisht për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe mosbindje ndaj gjykatës në kuptim të neneve 401(2) dhe (5) dhe 393 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, Kodi nr. 06/L-074, në shkelje të nenit 15(2) të Ligjit.³¹ Standardi mbi të cilin u bazuan këto konstatime ishte më i lartë se ai i dyshimit të bazuar që kërkohet sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit.³² Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se në këtë çështje gjyqësore nuk ka pasur zhvillime që do t'i shfuqizonin këto konstatime.

14. Rrjedhimisht, në mungesë të ndonjë informacioni apo zhvillimi që provon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Fazliu ka kryer vepra penale të përfshira në juridiksionin e DHS-së, sipas nenit 41(6)(a) dhe (10) të Ligjit.³³

C. DOMOSDOSHMERIA E PARABURGIMIT

15. Pas përmbushjes së standardit të nenit 41(6)(a) të Ligjit, arsyet që përlegjin heqjen e lirisë së personit duhet të jetë të *artikulueshme*, në kuptimin që duhet të specifikohen me hollësi.³⁴ Në këtë aspekt, neni 41(6)(b) i Ligjit pasqyron parimin se vazhdimi i paraburgimit të një personi mund të përlegjet vetëm në rast se ka tregues konkret të një nevoje të njëmendë të interesit publik që peshon më shumë se e drejta për liri e personit.³⁵ Rrjedhimisht, në marrjen e vendimit për vazhdimin e

³¹ Vendimi i Konfirmimit, para. 313(b).

³² *Shih* Vendimin e Konfirmimit, para. 42-43; [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 43. *Shih ngjashëm*, [Second Shala Detention Decision](#), (Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin e *Shalës*) para. 22; [Sixth Shala Detention Decision](#), (Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin e *Shalës*), para. 24.

³³ *Shih ngjashëm*, Vendimi i Parë mbi Paraburgimin në Transkriptin e Seancës së Paraqitjes së Parë, f. 67, rreshtat 8-10.

³⁴ *Shih* nenin 19(1.31) të KPPK-së, i cili e përkufizon termin “artikulueshëm” si: “pala e cila paraqet informacionin apo provën duhet të specifikojë në detaje informatën apo provën në të cilën mbështetet”. *Shih gjithashtu, për shembull*, [First Shala Detention Decision](#) (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e *Shalës*), para. 16; KSC-BC-2020-06, IA001/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Decision on Kadri Veseli's Appeal Against Decision on Interim Release](#) (Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit Kundër Vendimit në lidhje me Lirimin e Përkohshëm), (“Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*”), 30 prill 2021, publik, para. 15, 18.

³⁵ [SCCC 26 April 2017 Judgment](#) (Aktvendimi i DHSGJK-së i datës 26 prill 2017), para. 113.

paraburgimit paneli duhet të mbështetet në arsyetime të lidhura me çështjen në fjalë dhe në arsye konkrete.³⁶

16. Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu rikujton se, bazuar në provat e disponueshme, arsyet konkrete të artikulueshme duhet të mbështesin “besimin”³⁷ se ekziston ndonjë prej rreziqeve të parapara në nënparagrafët e nenit 41(6)(b) të Ligjit, çka nënkupton pranimin e mundësisë, e jo të pashmangshmërisë, që ato të ndodhin në të ardhmen.³⁸ Me fjalë të tjera, standardi që duhet zbatuar është më i ulët se pashmangshmëria, por më i lartë se thjesht mundësia që rreziku të materializohet.³⁹ Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu vëren se këto arsye janë alternative dhe se mjafton ekzistenca e një arsyeje për të vendosur mbi domosdoshmërinë e paraburgimit.⁴⁰

17. Sa i përket llojit të vlerësimit sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se, ndonëse përfshin një element të kompetencës diskrecionale,⁴¹ vlerësimi duhet të bazohet në faktet e çështjes dhe duhet të kryhet

³⁶ Shih [SCCC 26 April 2017 Judgment](#) (Aktvendimi i DHSGJK-së i datës 26 prill 2017), para. 115; [First Shala Detention Decision](#) (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Shalës), para. 16; KSC-BC-2020-06, IA004/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Hashim Thaçi's Appeal Against Decision on Interim Release](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm), (“Vendimi i Parë të Apelit mbi Paraburgimin e Thaçit”), 30 prill 2021, publik, para. 22. Shih gjithashtu ECtHR, [Khudoyorov v. Russia](#), no. 6847/02, Judgment (“*Khudoyorov v. Russia*”), 8 November 2005, para. 173.

³⁷ Shih pjesën e përgjithshme të nenit 41(6)(b) të Ligjit.

³⁸ Shih ngjashëm, [First Shala Detention Decision](#) (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Shalës), para. 16; [Second Shala Detention Decision](#) (Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin e Shalës), para. 24; [Sixth Shala Detention Decision](#) (Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin e Shalës), para. 26; [First Thaçi Detention Decision](#) (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Thaçit), para. 20, me referenca të mëtejshme.

³⁹ Shih gjithashtu, [First Veseli Detention Appeal Decision](#) (Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Veselit), para. 17; [First Shala Detention Decision](#) (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Shalës), para. 16.

⁴⁰ Shih ngjashëm, [First Shala Detention Decision](#) (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Shalës), para. 20; [First Thaçi Detention Decision](#) (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Thaçit), para. 25; KSC-BC-2023-12, IA001/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Decision on Isni Kilaj's Appeal Against Decision on Continued Detention](#) (Vendim mbi Apelin e Isni Kilajt kundër Vendimit mbi Vazhdimin e Paraburgimit), (“Vendimi i Apelit mbi Paraburgimin e Kilajt”), 28 janar 2025, publik, para. 17.

⁴¹ Shih ngjashëm, [First Thaçi Detention Decision](#) (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Thaçit), para. 21, me referenca të mëtejshme; [Kilaj Detention Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit mbi Paraburgimin e Kilajt), para. 16.

mbi bazë individuale duke mbajtur parasysh rrethanat personale të personit të paraburgosur.⁴² Gjatë vlerësimit të faktorëve relevantë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk i vlerëson ato në mënyrë fragmentare, por peshon të gjithë faktorët relevantë të marrë së bashku.⁴³

18. Së fundi, në lidhje me arsyet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(ii)-(iii) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake thekson se është e mjaftueshme që rreziqet mund të materializohet si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të personit të paraburgosur, pa qenë e nevojshme që ato të kryhen fizikisht prej tij.⁴⁴

1. Rreziku i arratisjes

19. Sa i përket rrezikut të arratisjes sipas nenit 41(6)(b)(i) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjykon se konstatimet e bëra në Vendimin për Arrestim dhe Vendimin e Parë për Paraburgimin janë ende të vlefshme, konkretisht se z. Fazliu: (i) është në dijeni të peshës së veprave penale për të cilat akuzohet, së bashku me dënimin e mundshëm që mund të marrë për këto vepra penale në rast se z. Fazliu shpallet fajtor;⁴⁵ dhe (ii) demonstroi shpërfillje të hapur ndaj ligjeve dhe rregullave të DHS-së.⁴⁶

20. Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu rikujton se z. Fazliu ka mundësi të arratiset duke udhëtuar lirisht në juridiksione ku nuk mund të kapet nga DHS-ja.⁴⁷ Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se z. Fazliu ka mjetet

⁴² Shih [First Shala Detention Decision](#) (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Shalës), para. 17; [First Thaçi Detention Decision](#) (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Thaçit), para. 21, me referenca të mëtejshme. Shih ngjashëm, ECtHR, [Aleksanyan v. Russia](#), no. 46468/06, Judgment, 22 December 2008, para. 179.

⁴³ Shih [First Shala Detention Decision](#) (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Shalës), para. 17; [First Thaçi Detention Decision](#) (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Thaçit), para. 21, me referenca të mëtejshme.

⁴⁴ Shih [First Shala Detention Decision](#) (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Shalës), para. 19; [First Thaçi Detention Decision](#) (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Thaçit), para. 24.

⁴⁵ Shih [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 81, me referencat; Vendimi i Parë mbi Paraburgimin në Transkriptin e Seancës së Paraqitjes së Parë, f. 67, rreshtat 16-17.

⁴⁶ Shih [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para 81.

⁴⁷ Shih [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 82; Vendimi i Parë mbi Paraburgimin në Transkriptin e Seancës së Paraqitjes së Parë, f. 67, rreshtat 17-21.

për t'i ikur drejtësisë.⁴⁸ Në veçanti, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton konstatimet e veta të mëparshme lidhur me karrierën e gjatë politike në Kosovë dhe lidhjet e ngushta të të akuzuarit me komandantë të dikurshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK"), përfshirë veteranë të UÇK-së me ndikim të fortë politik, në mes të të cilëve z. Thaçi.⁴⁹ Rrjedhimisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vazhdon të jetë e bindur se i akuzuari mund të mbështetet në rrjetin e gjerë të individëve me ndikim, prej të cilëve mund të kërkojë dhe të sigurojë mjete dhe mbështetje për t'u arratisur.⁵⁰ Në këtë kontekst, vlen të rikujtohet se duhet të vlerësohet rreziku i arratisjes dhe jo pashmangshmëria e saj.⁵¹

21. Krahas sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake i kushton rëndësi faktit se, që prej arrestimit të tij, z. Fazliu është në dijeni të provave që mbështesin Aktakuzën kundër tij dhe me të cilat është njohur gradualisht me anë të nxjerrjes së plotë të provave lidhur me sjelljen kriminale të pretenduar të tij.⁵²

22. Së fundi, Gjykatësja e Procedurës Paraprake i qëndron konstatimeve të veta të mëparshme se: (i) lidhjet e forta familjare të z. Fazliu në Kosovë vetëm e zvogëlojnë, por nuk e eliminojnë rrezikun që ai të arratiset, veçanërisht duke pasur parasysh rolin e mundshëm të djalit të tij, Fahri Fazliu ("djali i Fazliut"), në akuzat e ngritura kundër tij në këtë çështje gjyqësore; dhe (ii) nevoja e tij për kujdes të specializuar mjekësor në Kosovë nuk ka asnjë ndikim në rrezikun e arratisjes pasi ai mund të trajtohet dhe diku tjetër.⁵³

⁴⁸ Shih [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 83; Vendimi i Parë mbi Paraburgimin në Transkriptin e Seancës së Paraqitjes së Parë, f. 67, rreshtat 17-21.

⁴⁹ Shih [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 83.

⁵⁰ Shih [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 83; Vendimi i Parë mbi Paraburgimin në Transkriptin e Seancës së Paraqitjes së Parë, f. 67, rreshtat 17-21.

⁵¹ Shih *ngjashëm*, KSC-BC-2023-10, F00123/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Sabit Januzi's Request for Interim Release](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Sabit Januzit për Lirim të Përkohshëm), ("Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Januzit"), 8 dhjetor 2023, publik, para. 48.

⁵² Shih Paketat 6 dhe 8 të Materialit të Nxjerrë. Shih gjithashtu, *ngjashëm*, [Kilaj Detention Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit mbi Paraburgimin e Kilajt), para. 42.

⁵³ Shih [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 84; Vendimi i Parë mbi Paraburgimin në Transkriptin e Seancës së Paraqitjes së Parë, f. 68, rreshtat 1-2.

23. Rrjedhimisht, bazuar në sa më lart dhe në mungesë të ndonjë informacioni të ri që provon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se në lidhje me z. Fazliu vazhdon të ekzistojë rreziku i arratisjes.

2. Rreziku i pengimit të ecures së procesit të DHS-së

24. Sa i përket rrezikut të pengimit të ecures së procesit sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se vazhdojnë të ekzistojnë rrethanat e përshkruara në Vendimin për Arrestim dhe Vendimin e Parë për Paraburgimin,⁵⁴ konkretisht: (i) lloji i akuzave të konfirmuara kundër të akuzuarit, i cili ishte pjesëtar i një grupi të drejtuar nga z. Thaçi, me synimin për të ndikuar në mënyrë të paligjshme të dëshmitarët;⁵⁵ (ii) z. Fazliu demonstroi se kishte dijeni për synimet penguese të z. Thaçi dhe synimin e vet për t'i përmbushur ato; (iii) këmbëngulja dhe prirja e tij për pengim të procesit të DHS-së, duke ndihmuar për realizimin e interesave dhe urdhrave të udhëheqjes së lartë të UÇK-së,⁵⁶ dhe (iv) aftësia e tij për të marrë pëlqimin e njerëzve besnikë ndaj tij për pengimin e procesit të DHS-së, midis të cilëve edhe djali i Fazliut dhe persona të tjerë.⁵⁷

25. Krahës sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake e gjykon të rëndësishëm faktin se i akuzuari ka gjithnjë e më shumë dijeni për provat inkriminuese kundër tij në këtë çështje.⁵⁸ Në këtë aspekt, duke pasur parasysh pozitën e dikurshme të z. Fazliu në UÇK,⁵⁹ Gjykatësja e Procedurës Paraprake është bindur se, si rezultat i procesit të nxjerrjes në vijimësi të materialeve, i akuzuari ka më shumë motiv për të ndërhyrë ndaj dëshmitarëve. Në këtë aspekt, Gjykatësja e Procedurës Paraprake

⁵⁴ Shih [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 86; Vendimin e Parë mbi Paraburgimin në Transkriptin e Seancës së Paraqitjes së Parë, f. 68, rreshtat 3-7.

⁵⁵ [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 86, me shpjegime të mëtejshme; shih *ngjashëm*, [Kilaj Detention Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit mbi Paraburgimin e Kilajt), para. 43.

⁵⁶ Shih [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 86; Vendimin e Parë mbi Paraburgimin në Transkriptin e Seancës së Paraqitjes së Parë, f. 68, rreshtat 3-7.

⁵⁷ Shih [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 86; Vendimin e Parë mbi Paraburgimin në Transkriptin e Seancës së Paraqitjes së Parë, f. 68, rreshtat 3-7.

⁵⁸ Shih *ngjashëm*, [Kilaj Detention Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit mbi Paraburgimin e Kilajt), para. 44.

⁵⁹ Shih [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 83.

thekson se rreziku i pengimit të procesit nuk ka nevojë të materializohet përmes kontaktimit të dëshmitarit 1 dhe/ose dëshmitarëve të tjerë nga z. Fazliu, por, për shembull, mund të materializohet përmes bashkërendimit të mëtejshëm me djalin e Fazliut dhe/ose bashkëpunëtorë të tjerë në rrjetin e UÇK-së dhe/ose qarqe politike.⁶⁰

26. Në këtë aspekt, Gjykatësja e Procedurës Paraprake thekson se faktorët e mësipërm i vlerëson në kontekstin e atmosferës së përgjithshme të frikës dhe frikësimit në Kosovë kundër dëshmitarëve aktualë dhe të mundshëm në DHS.⁶¹ Në këtë kontekst, Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjykon se, duke pasur parasysh lidhjet e lartpërmendura të tij, është veçanërisht i lartë rreziku që z. Fazliu të ushtrojë trysni ndaj dëshmitarëve.⁶²

27. Rrjedhimisht, bazuar në sa më lart dhe në mungesë të ndonjë informacioni të ri që provon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Fazliu të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së.

3. Rreziku i kryerjes së veprave penale të mëtejshme

28. Lidhur me rrezikun e kryerjes së veprave penale të mëtejshme sipas nenit 41(6)(b)(iii) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se, ndonëse ekzistenca e rrezikut të pengimit të procesit nuk do të thotë automatikisht rrezik i kryerjes së veprave penale të mëtejshme, faktorët në të cilat bazohet i pari janë relevantë për vlerësimin e të dytit në rrethanat aktuale.⁶³ Në këtë aspekt, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vë në dukje se faktorët relevantë për t'u marrë parasysh

⁶⁰ Shih më lart, para. 20. Shih ngjashëm, [First Januzi Detention Decision](#) (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Januzit), para. 54.

⁶¹ Shih [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 88, me referencat; Vendimin e Parë mbi Paraburgimin në Transkriptin e Seancës së Paraqitjes së Parë, f. 68, rreshtat 3-7.

⁶² Shih ECtHR, [Štvrtecký v. Slovakia](#), no. 55844/12, Judgment, 5 June 2018, para. 61; [Podeschi v. San Marino](#), no. 66357/14, Judgment, 13 April 2017, para. 149; [Staykov v. Bulgaria](#), no. 16282/20, Judgment, 8 June 2021, para. 83; [Pantano v. Italy](#), no. 60851/00, Judgment, 6 November 2003, para. 70.

⁶³ Shih [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 90; Vendimin e Parë mbi Paraburgimin në Transkriptin e Seancës së Paraqitjes së Parë, f. 68, rreshtat 3-7. Shih gjithashtu [First Shala Detention Decision](#) (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Shalës), para. 39.

janë të njëjtë me ata të përmendur në paragrafët 24-26 më lart në lidhje me pengimin e procesit.

29. Për këto arsye, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se ekziston rreziku që i akuzuari të përsërisë veprat penale që pretendohet se i ka kryer.⁶⁴

30. Rrjedhimisht, bazuar në sa më lart dhe në mungesë të ndonjë informacioni të ri që provon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Fazliu të kryejë vepra penale të mëtejshme.

4. Përfundim

31. Bazuar në sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se z. Fazliu mund të arratiset, të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së dhe të kryejë vepra penale të mëtejshme, çka bën të domosdoshëm vazhdimin e paraburgimit të z. Fazliu në pajtim me nenin 41(6)(b) të Ligjit. Gjykatësja e Procedurës Paraprake më poshtë do të vlerësojë nëse këto rreziqe mund të zvogëlohen mjaftueshëm me ndonjë prej kushteve për lirimin e z. Fazliu.

D. LIRIMI ME KUSHT

32. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se, gjatë marrjes së vendimit nëse një person duhet të lirohet apo të mbahet në paraburgim, ajo duhet të shqyrtojë të gjitha masat e propozuara dhe alternative për parandalimin e rreziqeve në nenin 41(6)(b) të Ligjit.⁶⁵

33. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton konstatimet e mëparshme në Vendimin e Parë për Paraburgimin se, ndonëse mban parasysh gatishmërinë e z. Fazliu, në atë kohë, për të venë dorëzani në shumën 2.550 euro dhe për t'iu

⁶⁴ Shih [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 90; Vendimin e Parë mbi Paraburgimin në Transkriptin e Seancës së Paraqitjes së Parë, f. 68, rreshtat 3-7.

⁶⁵ Në lidhje me detyrimin për të shqyrtuar "masa alternative" shih [SCCC 26 April 2017 Judgment](#) (Aktvendimi i DHSGJK-së i datës 26 prill 2017), para. 114. Shih gjithashtu ECtHR, [Buzadji v. the Republic of Moldova](#), no. 23755/07, Judgment ("*Buzadji v. Moldova*"), 5 July 2016, para. 87; [Idalov v. Russia](#), no. 5826/03, Judgment, 22 May 2012, para. 140.

përmbajtur çdo kushti tjetër që gjykohej i përshtatshëm, ajo vazhdon të ishte e bindur se asnjë prej kushteve të propozuara nga Mbrojtja nuk mund të zvogëlonte mjaftueshëm rreziqet ekzistuese.⁶⁶

34. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vazhdon të ketë mendimin se asnjë nga kushtet, qoftë ato të propozuara nga Mbrojtja, apo kushte të tjera që Gjykatësja e Procedurës Paraprake mund të vendosë *proprio motu*,⁶⁷ nuk mund të zvogëlojnë, në këtë fazë, rreziqet ekzistuese, në veçanti rrezikun që i akuzuari të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së, ose të kryejë vepra penale të mëtejshme. Konkretisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake është e mendimit se çdo kusht i mundshëm që mund të vendoset: (i) nuk trajton, për shembull, mundësinë që z. Fazliu të përdorë pajisje komunikimi që u përkasin personave të tjerë, ose që t'u kërkojë të tjerëve të përdorin pajisjet e tyre për këto qëllime; dhe (ii) nuk mund të garantojë, për shembull, mbikëqyrje të efektshme të komunikimeve të z. Fazliu. Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake veçanërisht mban parasysh se, pavarësisht kushteve të vendosura, i akuzuari do të kishte aftësinë, motivin dhe mundësinë për t'i kontaktuar dëshmitarët nëpërmjet djalit të tij.⁶⁸

35. Sipas Gjykatësës së Procedurës Paraprake, ndonëse rreziku i mesazheve dhe udhëzimeve të paligjshme nuk mund të eliminohet plotësisht, masat në fuqi në objektin e paraburgimit të DHS-së, të marra në tërësi, ofrojnë garanci të forta kundër vizitave dhe komunikimeve të pamonitoruara me anëtarë të familjes dhe vizitorë të miratuar paraprakisht, për ta zvogëluar sa më shumë që të jetë e mundshme rrezikun e pengimit të procesit dhe kryerjen e veprave penale të mëtejshme.⁶⁹ Në

⁶⁶ Shih Vendimin e Parë mbi Paraburgimin në Transkriptin e Seancës së Paraqitjes së Parë, f. 60, rreshtat 5-19; f. 68, rreshtat 21-23.

⁶⁷ Shih KSC-BC-2020-06, IA017/F00011/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Hashim Thaçi's Appeal Against Decision on Review of Detention](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit), 5 prill 2022, publik, para. 51.

⁶⁸ Shih më lart, para. 24-26.

⁶⁹ Ngjashëm, KSC-BC-2020-06, IA010/F00008/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Hashim Thaçi's Appeal Against Decision on Review of Detention](#) (Version i Redaktuar Publik

lidhje me këtë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se Administratorja dhe paneli, që kanë qasje të pakufizuar në informacionin konfidencial lidhur me dëshmitarët dhe viktimat, mund të ndërmarrin veprime më shpejt se autoritete të tjera që veprojnë sipas një kornize të ndryshme.⁷⁰

36. Rrjedhimisht, bazuar në sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se kushtet për lirim të akuzuarit të propozuara prej Mbrotjtjes së z. Fazliu gjatë paraqitjes së parë të tij dhe/ose çfarëdo kushtesh të arsyeshme *shtesë* të vendosura nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake, mbeten të pamjaftueshme për të zvogëluar në masën e duhur rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(i)-(iii) të Ligjit.

E. PROPORCIONALITETI I PARABURGIMIT

37. Fillimisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton rëndësinë e parimit të proporcionalitetit në përcaktimin e arsyeshmërisë së paraburgimit në pritje të gjykimit, sikurse pasqyrohet në rregullën 56(2) të Rregullores.⁷¹ Kohëzgjatja e paraburgimit në pritje të gjykimit është faktor që duhet të merret parasysh së bashku me shkallën e rreziqeve të përshkruara në nenin 41(6)(b) të Ligjit, në mënyrë që, duke mbajtur parasysh të gjithë faktorët, të përcaktohet nëse vazhdimi i paraburgimit “ka pushuar së qeni i arsyeshëm” dhe personi duhet të lirohet.⁷² Sidoqoftë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake thekson se vlerësimi nëse periudha e kaluar në paraburgim para fillimit të gjykimit është e arsyeshme, nuk mund të bëhet teorikisht, por në bazë të fakteve të secilës çështje gjyqësore dhe në përputhje me

i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit), (“Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Thaçit”), 27 tetor 2021, publik, para. 68.

⁷⁰ KSC-BC-2023-10, F00165, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Review of Detention of Haxhi Shala](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Haxhi Shalës), 9 shkurt 2024, publik, para. 54.

⁷¹ KSC-BC-2020-07, IA001/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Decision on Hysni Gucati's Appeal on Matters Related to Arrest and Detention](#) (Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e Tij në Paraburgim), 9 dhjetor 2020, publik, para. 72-73; KSC-BC-2018-01, IA007/F00007, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt*, 13 maj 2024, konfidencial, para. 18. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 15 maj 2024, [IA007/F00007/RED](#).

⁷² [Second Thaçi Detention Appeal Decision](#) (Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Thaçit), para. 49, me referenca të mëtejshme.

veçoritë specifike të saj.⁷³ Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se ky vlerësim mund të bazohet vetëm në rrethanat në kohën e rishikimit dhe jo në atë që mund të ndodhë ose nuk mund të ndodhë në një të ardhme të parashikueshme.⁷⁴

38. Duke pasur parasysh se z. Fazliu mbahet në paraburgim që nga 5 dhjetori 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake është e mendimit se aspekti i proporcionalitetit nuk mund të shtrohet në këtë fazë të hershme të procedurës. Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mban parasysh se që nga Vendimi i Parë për Paraburgimin: (i) është mbajtur një konferencë për ecurinë e çështjes dhe për organizimin e nxjerrjes së provave midis palëve;⁷⁵ (ii) Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka lëshuar Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To, ku përcaktohen afatet për nxjerrjen e provave midis palëve me qëllim sigurimin e efikasitetit të procesit;⁷⁶ dhe (iii) ZPS-ja ka përfunduar nxjerrjen e të gjitha materialeve sipas rregullës 102(1)(a).⁷⁷ Rrjedhimisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake është e mendimit se procedurat po avancojnë me shpejtësi.

39. Gjithashtu, në bazë të nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, paraburgimi i z. Fazliu do të rishikohet rregullisht me kalimin e dy (2) muajve nga vendimi i fundit për paraburgimin, ose kurdo që bëhet kërkesë, ose *proprio motu*, nëse kanë ndryshuar rrethanat që nga vlerësimi i fundit.

40. Bazuar në sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se koha që z. Fazliu ka kaluar në paraburgim para gjykimit nuk është e paarsyeshme sipas kuptimit të rregullës 56(2) të Rregullores.

⁷³ ECtHR, [Buzadji v. Moldova](#), para. 90.

⁷⁴ KSC-BC-2023-10, F00325, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Third Decision on Review of Detention of Haxhi Shala](#) (Vendimi i Tretë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Haxhi Shalës), 5 qershor 2024, publik, para. 47.

⁷⁵ KSC-BC-2023-12, Transkripti i seancës, 17 dhjetor 2024, publik, f. 126-198.

⁷⁶ KSC-BC-2023-12, F00100, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Framework Decision on Disclosure of Evidence and Related Matters](#), (Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje në lidhje me To), 20 dhjetor 2024, publik.

⁷⁷ *Shih* Paketat 6, 8 të Materialit të Nxjerrë.

V. VENDIM

41. Bazuar në arsyet e lartpërmendura, Gjykatësja e Procedurës Paraprake:

- (a) **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Fazliu;
- (b) **URDHËRON** z. Fazliu që, në qoftë se dëshiron, të dorëzojë parashtime lidhur me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit deri **të hënën, 10 mars 2025**, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores; dhe
- (c) **URDHËRON** ZPS-në, nëse z. Fazliu vendos të mos dorëzojë parashtime brenda afatit të lartpërmendur, të dorëzojë parashtime lidhur me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Fazliu deri **të premten, 14 mars 2025**, dhe z. Fazliu, në qoftë se dëshiron, të dorëzojë përgjigjen e tij deri **të premten, 21 mars 2025**.

_____/nënshkrimi/

Gjykatëse Marzhori Masëlo
Gjykatëse e Procedurës Paraprake

E premte, 7 shkurt 2025

Në Hagë, Holandë.